

VENDIM
Nr. 196, datë 4.3.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, TË OBJEKTEVE DHE TROJEVE FUNKSIONALE, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 2 343 M², PJESE E PRONËS NR. 1042, ME EMËRTIM “OBJEKTE TË REPARTIT USHTARAK NR. 5013”, ME VENDNDODHJE NË SYZES, BERAT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të objekteve dhe trojeve funksionale (S1 e S2), përkatësisht 2004 (dy mijë e katër) m² dhe 339 (treqind e tridhjetë e nëntë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 2343 (dy mijë e treqind e dyzet e tre) m², pjesë të pronës nr. 1042, me emërtim “Objekte të Repartit Ushtarak nr. 5013”, me vendndodhje në Syzes, Berat, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për zgjerimin e rrugës nacionale automobilistike Lushnjë-Berat.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqen objektet dhe trojet funksionale (S1 e S2), përkatësisht 2004 (dy mijë e katër) m² dhe 339 (treqind e tridhjetë e nëntë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 2343 (dy mijë e treqind e dyzet e tre) m², nga objektet dhe trualli funksional i pronës nr. 1042, me emërtim “Objekte të Repartit Ushtarak nr. 5013”, me vendndodhje në Syzes, Berat, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

3. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës së Forcave të Armatosura, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, të ndërtojë rrethimin, në kufijtë e rinj të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike, që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer ato në gjendjen e tyre të mëparshme. Për këtë qëllim, të hartohet një aktmarrëveshje e përbashkët, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Komandës Mbështetëse të Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe kryeregjistruesi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI
PRONA NR. 1042 (ISH REPARTI USHTARAK NR. 5013, SYZES, BERAT)
 (Sipërfaqja që zë projekti i rrugës Lushnjë-Berat mbi pronën 1042)



